

**GJYKATA E APELIT**  
**PRISHTINË**

---

**Numri i lëndës:** **PAKR 397/14**

**Më:** **24 mars 2015**

**Gjykata Themelore:** **Prishtinë, PKR 955/13**

Origjinali: **anglisht**

---

Gjykata e Apelit, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarës së EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati, kryetare e kolegjit dhe gjyqtare raportuese, gjyqtarës së EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova dhe gjyqtarit kosovar Fillim Skoro, si anëtarë të kolegjit, me asistimin e zyrtarit ligjor të EULEX-it Alan Vasak, i cili vepron në cilësinë e procesmbajtësit,

në çështjen penale lidhur me të pandehurin:

**I.R.;**

i akuzuar nga Zyra e Prokurorisë Special të Republikës së Kosovës (PSRK) me aktakuzën PPS 85/2013 e ngritur më 25 shtator 2013 për:

Krime lufte kundër popullatës civile, e paraparë dhe e dënueshme me nenin 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), aktualisht e sanksionuar me nenin 31 dhe 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), në kundërshtim me nenin 3 të përbashkët për katër konventat e Gjenevës të 1949, dhe nenet 4, 5 (1) të Protokollit II shtesë të datës 8 qershor 1977, shtojcë e konventave të Gjenevës 1949, të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevante, i akuzuari si pjesëtar rezervë i policisë së Serbisë, në bashkëkryerje me së paku dhjetë anëtarë të tjerë të forcave të ndryshme serbe (përfshirë Policin rezervë dhe paramilitarët) kanë cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e rreth 40 civilëve meshkuj shqiptarë (përfshirë B.B., H.B. dhe D.B.) të grumbulluar në stacionin e autobusit në komunën e Fushë Kosovës më 26 mars 1999;

i gjykuar nga shkalla e parë e Gjykatës Themelore të Prishtinës me aktgjykimin PKR 955/13, të datës 12 shkurt 2014, me të cilin i pandehuri I.R. ishte shpallur fajtor dhe dënuar me 8 (tetë) vjet burgim;

duke vendosur rreth ankesës së parashtruar nga mbrojtësi Brkljač Miodrag më 28 prill 2014 kundër aktgjykimit PKR 955/13, të lëshuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës më 12 shkurt 2014;

pas marrjes parasysh të përgjigjes së PSRK-së, të parashtruar më 20 maj 2014;

pas marrjes parasysh të propozimit të prokurorit të apelit të shtetit, të parashtruar më 22 gusht 2014,

pas mbajtjes së seancës së hapur të Gjykatës së Apelit më 24 mars 2015;

pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit më 24 mars 2015;

duke vepruar në përputhje me nenet 389, 390, 394, 398 dhe 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP);

merr këtë:

---

## AKTGJYKIM

---

**I. Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit Miodrag Brkljač për të pandehurin I.R., e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR 955/13 të datës 12 shkurt 2014.**

**II. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR 955/13 i datës 12 shkurt 2014 ndryshohet *ex officio* në pjesën e tij të dënimit. Dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit I.R. për veprën penale të krime lufte kundër popullatës civile, e kryer në bashkë-kryerje, sipas neneve 22, 142 të KP RSFJ-së ndryshohet me sa vijon:**

**I pandehuri I.R. dënohet me 6 (gjashtë) vjet burgim. Koha e kaluar në paraburgim nga data 26 korrik 2013 llogaritet në dënim.**

**III. Vërtetohet pjesa tjetër e aktgjykimit.**

## ARSYETIMI

---

### I. HISTORIKU I PROCEDURËS

Hetimet penale ndaj të pandehurit ishin iniciuar nga prokurori i PSRK-së më 14 nëntor 2012.

Prokurori special ka ngritur aktakuzën PPS 85/2013 të datës 24 shtator 2013, më 25 shtator 2013.

I pandehuri ishte arrestuar më 26 korrik 2013 dhe prej asaj kohe është mbajtur në paraburgim.

Shqyrtimi gjyqësor në këtë lëndë ishte mbajtur më 15, 16, 22 dhe 28 janar 2014 dhe 4, 6 e 12 shkurt 2014 me aktgjykimin e shpallur më 12 shkurt 2014. Trupi gjykues, me një aktvendim të ndarë, ka vazhduar edhe paraburgimin ndaj të pandehurit derisa aktgjykimi të marrë formën e prerë.

Aktgjykimi me shkrim i është dorëzuar të pandehurit më 14 prill 2014 dhe mbrojtësit më 11 prill 2014. I pandehuri, përmes mbrojtësit të tij, e ka apeluar aktgjykimin e parashtruar më 28 prill 2014.

Prokurori i PSRK-së ka parashtruar përgjigje në ankesë më 20 maj 2014.

Lënda ishte transferuar në Gjykatën e Apelit për vendim përkitazi me ankesën më 1 gusht 2014.

Prokurori i apelit i shtetit ka parashtruar propozim më 22 gusht 2014.

Në praninë e të pandehurit, mbrojtësit të tij dhe prokurorit të apelit të shtetit Judit Eva Tatrai është mbajtur seanca e kolegjit të Gjykatës së Apelit më 24 mars 2015.

Kolegji është këshilluar dhe ka votuar mbi çështjen më 24 mars 2015.

### II. PARASHTRESAT E PALËVE

#### A. Ankesa e mbrojtjes

Mbrojtësi Miodrag Brkljač ka parashtruar ankesë në emër të të pandehurit mbi bazën e

- a. Shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale
- b. Shkeljes së ligjit penal
- c. Vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike
- d. Vendimit mbi sanksionet penale

dhe i propozon Gjykatës së Apelit që ta prish aktgjykimin dhe këtë lëndë penale ta kthej në rigjykim.

Mbrojtësi paraqet se nuk ka prova që i pandehuri në të vërtetë ishte identifikuar në mënyrë të sigurt nga dëshmitarët e prokurorisë. Gjykata Themelore në mënyrë të gabueshme i ka vlerësuar provat e administruara, në mënyrë të gabueshme e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe për këtë arsye edhe gabimisht e ka zbatuar ligjin material kur e ka shpallur të pandehurin fajtor në vend se ta lirojë atë.

Mbrojtësi më tej paraqet se Gjykata Themelore nuk ka vepruar në përputhje me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Kz. Nr. 186/03 (V.) sepse Gjykata Themelore nuk ka arritur që në mënyrë të saktë të shqyrtojë dëshmitë e dëshmitarëve. Gjykata Themelore plotësisht i ka injoruar kontradiktat dhe kundërthëniet në dëshmi të cilat është dashur të qojnë në përfundimin se dëshmitarët nuk mund të trajtoheshin si të besueshëm. Dëshmitarët H.J., S.G., H.B., N.B. dhe S.J. të gjithë kanë dhënë deklaratat kundërthënëse dhe kontradiktore e për këtë arsye edhe identifikimi i të pandehurit në vendin e ngjarjes nuk duhet të jetë i besueshëm. Pohimi i Gjykatës Themelore se në realitet ajo i ka marrë në konsideratë kundërthëniet dhe kontradiktat është i pavërtetë, e edhe motivimit të Gjykatës Themelore pse dëshmitarë të caktuar janë konsideruar të besueshëm, i mungon justifikimi i duhur dhe përmbajtjesor.

Si përfundim, dallimet e mëdha dhe të shumta në mes të dëshmive të dëshmitarëve të cilët e kanë identifikuar të pandehurin, duhet, të paktën, të ngritin dyshim serioz nëse i pandehuri ishte apo nuk ishte i pranishëm në vendin e krimit dhe për këtë arsye aktgjykimin duhet të priset.

Mbrojtësi po ashtu vë në pah se nuk është e pranueshme që kallëzimi penalë ishte ngritur pas më shumë se 11 vjetësh që nga kryerja e veprës penale.

Mbrojtësi më tej propozon që menjëherë të ndërpritet masa e paraburgimit ashtu që i pandehuri të mund të mbrohet në liri.

## B. Përgjigja e PSRK-së

Prokurori special ka paraqitur përgjigje ndaj ankesës së mbrojtësit Miodrag Brljac dhe kërkon nga Gjykata e Apelit ta refuzojë ankesën si të pabazuar dhe ta vërtetojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

Prokurori special paraqet se nga aktgjykimin me shkrim është e qartë se Gjykata Themelore e ka shqyrtuar gjendjen faktike dhe provat në tërësi dhe me kompetencë e për këtë arsye nuk ka bazë për ankesë bazuar në vërtetimin të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Më tej prokurori special paraqet se nga aktgjykimin i kundërshtuar është më se e dukshme se Gjykata Themelore me shumë kujdes e ka shqyrtuar çështjen e identifikimit. Të gjitha mospërputhjet e pohuara ose

provat kundërthënëse të ngritura në ankesë nga mbrojtja tashmë kanë qenë të peshuara, shqyrtuara dhe arsyetuara me kujdes nga Gjykata Themelore. Prandaj Gjykata Themelore e ka kryer detyrën e saj në mënyrë të drejtë në përputhje me nenin 370 KPPK-së.

Lidhur me paraqitjen e çështjes më herët, prokurori paraqet se disa nga dëshmitarët në fakt e kanë paraqitur incidentin më parë.

### C. Propozimi nga Zyra e Prokurorisë së Apelit

Prokurori i apelit ka parashtruar propozim për ta refuzuar ankesën si të pabazë, për ta vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në tërësi dhe më tej për ta refuzuar propozimin për ndërprerjen e paraburgimit si të pabazë.

Prokurori i apelit miraton përgjigjen e prokurorit të PSRK-së.

Për më tepër prokurori i apelit paraqet se provat e dëshmitarëve në lëndën aktuale mbështesin shqyrtimin e standardeve të përcaktuara me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Kz. Nr. 186/03, për shkak se kontradiktat ose kundërthëniet në deklaratat e dëshmitarëve nuk i përkasin veprimeve të cilat i atribuohen të akuzuarit ose kohës dhe vendit të veprimeve të tij. Përveç kësaj, kundërthëniet e theksuara nga mbrojtësi nuk ndërlidhen me njohjen e të akuzuarit nga dëshmitarët sepse ata të gjitha e kanë njohur atë pasi që ai ka qenë komshi i tyre për një kohë të gjatë dhe jo duke u bazuar në veshjen dhe kapelën/shaminë e tij. Së fundi, prokurori i apelit paraqet se ankesa është e pa meritë.

## **III. GJETJET E KOLEGJIT**

### A. Kompetenca

Në përputhje me nenin 472 (1) të KPP-së, kolegji e ka shqyrtuar kompetencën e vet dhe pasi që nuk ka pasur asnjë kundërshtim nga palët, atij i mjafton se: në përputhshmëri me Ligjin mbi gjykatat, përzgjedhja dhe caktimi i lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë - Ligji nr. 03/L-053 i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-273 dhe i qartësuar përmes Marrëveshjes së bërë në mes të Shefit të Misionit të EULEX-it në Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të datës 18 qershor 2014, kolegji nxjerr përfundimin se EULEX-i ka kompetencë në këtë lëndë dhe se kolegji është kompetent për të vendosur për lëndën përkatëse i përbërë nga një gjyqtar i Kosovës dhe dy gjyqtarë të EULEX-it.

## B. Pranueshmëria e ankesës

Ankesa është e pranueshme. Aktgjykimi i arsyetuar i është dorëzuar të pandehurit më 14 prill 2014. Ankesa në emër të të pandehurit ishte parashtruar brenda afatit 15-ditor në përputhje me nenin 380 (1) të KPP-së. Ankesa ishte parashtruar nga personi i autorizuar dhe i përmban të gjitha informacionit e nevojshme sipas nenit 376 e më tej të KPP-së.

## C. Kredibiliteti dhe besueshmëria e dëshmitarëve

Mbrojtësi kundërshton kredibilitetin dhe besueshmërinë e dëshmitarëve H.J., S.G., N.B.1, N.B.2, S.J., B.B. dhe H.B. dhe pohon se i pandehuri nuk ishte i pranishëm në vendin e krimit e për këtë arsye edhe është i pafajshëm. Ankesa e mbrojtësit shtjellon kundërthëniet dhe kontradiktat e deklaratave të dëshmitarëve kryesisht lidhur me provat e dhëna nga dëshmitarët sa i përket veshjes së të pandehurit mbi të cilin është bazuar identifikimi i të pandehurit në vendin e ngjarjes.

Si vërejtje e përgjithshme, lidhur me deklaratat e dëshmitarit, kolegji vëren se është i vetëdijshëm për vështirësitë të cilat lidhen me identifikimin dhe/ose njohjen e provave dhe se me shumë kujdes duhet të vlerësojë secilën provë të tillë para se ta pranojë si bazë për mbështetje të dënimit.<sup>1</sup> Duke e pasur këtë në konsideratë, kolegji me kujdes i ka analizuar deklaratat e dëshmitarëve në këtë procedurë penale bashkë me arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar të Gjykatës Themelore. Kolegji më tej me vëmendje i ka shqyrtuar pohimet e paraqitura në ankesë, përgjigjen e PSRK-së dhe propozimin e prokurorit të apelit.

Në aktgjykimin e kundërshtuar, Gjykata Themelore në hollësi i ka analizuar provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Sipas këndvështrimit të kolegjit, Gjykata Themelore ka arritur në konkluzione logjike në vlerësimin e saj të atyre provave. Kolegji e ka shqyrtuar analizën e tërësishme të gjetjeve faktike e cila është treguar në faqet nga 48 deri në 65 të aktgjykimit të kundërshtuar (renditja e faqeve në gjuhën angleze), dhe e miraton këtë analizë në tërësinë e saj. Kolegji me vëmendje të posaçme e ka shqyrtuar analizën e Gjykatës Themelore lidhur me kundërthëniet dhe kontradiktat e provave të dhëna nga dëshmitarët, e të trajtuara në aktgjykimin e kundërshtuar në faqet nga 55 deri në 57 (renditja e faqeve në gjuhën angleze). Kolegji është plotësisht i bindur me konkluzionet dhe arsyetimin e Gjykatës Themelore dhe nuk gjen asnjë kontradiktë në qëndrimin e Gjykatës Themelore. Kolegji pajtohet me këtë arsyetim dhe për më tepër, e konsideron atë në përputhje me parimet e përcaktuara në vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Kz. Nr. 186/03 (V.).

---

<sup>1</sup> *Prokurori v. Kupreskic et al. (aktgjykimi mbi ankesën)*, IT-95-16-A, Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), 23 tetor 2001, paragrafët 34-41. *Prokurori v. Clément Kayishema dhe Obed Ruzindana (aktgjykim)*, ICTR-95-1-T, Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruandën (TPNR), 21 maj 1999, paragrafët 71-72. *Prokurori v. Haradinaj et al. (aktgjykim)*, IT-04-84-T, Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë (TPNJ), 3 prill 2008, paragrafi 29.

Kolegji nuk e sheh aspak të nevojshme për ta përsëritur analizën e plotë të detajuar të Gjykatës Themelore. Megjithatë kolegji do t'i shtjellojë çështjet në vazhdim.

*a. S.G., N.B., S.J. dhe H.B.*

Të gjitha dëshmitaret S.G., N.B., S.J. dhe H.B. e kanë identifikuar të pandehurin si një prej kryerësve të veprës penale më 26 mars 1999. Në formë të përmbledhur:

- S.G. ka dëshmuar se e njohte të pandehurin që nga koha kur i pandehuri në fjalë ishte myshteri në dyqanin e saj dhe se e njohte familjen e të pandehurit për një periudhë 6 deri në 7 vjet. Ajo ka deklaruar se e kishte njohur të pandehurin në vendin e krimit dhe e kishte pyetur a ishte 'I.', pyetje të cilën e kishte pohuar i pandehuri në fjalë.<sup>2</sup>
- N.B. ka dëshmuar se e njohte të pandehurin që nga fëmijëria dhe se ai kishte qenë fqinji i saj. Ajo dëshmoi se e njohte të pandehurin nga dukja dhe nga zëri i tij.<sup>3</sup>
- S.J. ka dëshmuar se e njohte të pandehurin qysh nga koha kur ishin fëmijë dhe se kishin jetuar afër njëri tjetrit. Ai deklaroi se e njohte shumë mirë të pandehurin dhe se para luftës herë pas here shihej me të. Ai deklaroi se e kishte njohur të pandehurin në fytyrë dhe nga mënyra e të folurit të tij.<sup>4</sup>
- H.B. ka dëshmuar se i pandehuri ishte fqinji i saj dhe se familja e burrit të saj njiheshin me të qysh më parë. Ajo deklaroi se e kishte njohur të pandehurin duke u bazuar në figurën e tij trupore si dhe për shkak se kryerësit vazhdimisht iu referoheshin njëri tjetrit në emër.<sup>5</sup>

Të gjitha dëshmitaret e kanë njohur të pandehurin si një prej kryerësve që ka qenë i pranishëm gjatë kryerjes së veprës penale. Për më tepër, është e qartë nga deklaratat e tyre se të gjitha dëshmitaret e kanë njohur të pandehurin më herët para kryerjes së veprës penale më datën 26 mars 1999. Kolegji konsideron se besueshmëria e njohjes dhe identifikimit të të pandehurit nga ana e dëshmitarëve përforcohet me atë se dëshmitaret e kanë njohur të pandehurin para veprës penale.

---

<sup>2</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të Gjykatës Themelore të Prishtinës (PKR 955/13) i seancës së mbajtur më 22 janar 2014, faqe 9 (versioni në gjuhën angleze).

<sup>3</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të Gjykatës Themelore të Prishtinës (PKR 955/13, GJPP 413/2012, PPS 85/2013) i seancës së mbajtur më 16 janar 2014, faqe 23 dhe 25 (Versioni në gjuhën angleze).

<sup>4</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të Gjykatës Themelore të Prishtinës (PKR 955/13, GJPP 413/2012, PPS 85/2013) i seancës së mbajtur më 16 janar 2014, faqe 5 dhe 9 (Versioni në gjuhën angleze).

<sup>5</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të Gjykatës Themelore të Prishtinës (PKR 955/13) i seancës së mbajtur më 22 janar 2014, faqe 18 dhe 23 (Versioni në gjuhën angleze).

Duke e pasur parasysh atë që u tha dhe duke i marrë parasysh rrethanat – ashtu siç thuhet në faqet 48 deri në 57 të aktgjykimit të kundërshtuar (faqeve sipas versionit në gjuhën angleze) – lidhur me identifikimin e të pandehurit nga dëshmitaret, kolegji gjen se provat e dhëna nga dëshmitaret në fjalë lidhur me identifikimin e të pandehurit në vendin e krimit, një identifikim i tillë është i besueshëm dhe kredibil. Për këtë arsye, kolegji pajtohet me vlerësimin e Gjykatës Themelore se ka prova të mjaftueshme të besueshme dhe kredibile në formë të deklaratave të dëshmitareve për ta vërtetuar se i pandehuri vërtet ka qenë i pranishëm në vendin e krimit.

Sa iu përket mospërputhjeve dhe kundërshtive në deklaratat e dëshmitareve kur bëhet fjalë për veshmbathjen e të pandehurit, kolegji se është më pak e rëndësishme se saktësisht çfarë veshjesh kishte veshur i pandehuri në fjalë, që mund të shpjegohet me pasaktësinë e perceptimit apo me probleme të memories, gjë e cila nuk ndikon në besueshmërinë e deklaratave si tërësi. Në veçanti, duke e pasur parasysh se grupi i kryerësve përbëhej nga shumë persona dhe një a më shumë persona të grupit kanë mundur (po ashtu) të kenë veshur (përzierje) të veshmbathjeve të përmendura duke ndikuar kështu në kujtesën e dëshmitareve kur kemi të bëjmë me saktësisht çfarë rrobash kishte veshur i pandehuri në fjalë. Prandaj kolegji konsideron se nga ky aspekt deklaratat e dëshmitareve kanë mospërputhje dhe kundërshti në mes vete.

- S.G., e cila e ka identifikuar të pandehurin në vendin e krimit duke e përshkruar se kishte rroba policie dhe një maskë<sup>6</sup>;

- N.B., e cila e ka identifikuar të pandehurin në vendin e krimit duke e përshkruar se kishte pantallona kamuflazhi dhe një shami<sup>7</sup>;

- S.J., i cili e ka identifikuar të pandehurin në vendin e krimit duke e përshkruar se kishte rroba të paramilitarëve, një helm të me xham mbrojtës dhe përfundi një kapelë të zezë<sup>8</sup>; dhe

- H.B., e cila e ka identifikuar të pandehurin në vendin e krimit duke e përshkruar se kishte të veshur pantallona të gjelbër, një majicë të bardhë dhe një shami<sup>9</sup>,

Janë deklarata që përmbajnë në vete mospërputhje të pranueshme. Sipas pikëpamjes së kolegjit mospërputhjet në fjalë nuk ua pakësojnë kredibilitetin apo besueshmërinë provave të deklaratave të dëshmitareve kur kemi të bëjmë me njohjen dhe identifikimin e të pandehurit.

---

<sup>6</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të Gjykatës Themelore të Prishtinës (PKR 955/13) i seancës së mbajtur më 22 janar 2014, faqe 7 (Versioni në gjuhën angleze).

<sup>7</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të Gjykatës Themelore të Prishtinës (PKR 955/13, GJPP 413/2012, PPS 85/2013) i seancës së mbajtur më 16 janar 2014, faqe 23 (Versioni në gjuhën angleze).

<sup>8</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të Gjykatës Themelore të Prishtinës (PKR 955/13, GJPP 413/2012, PPS 85/2013) i seancës së mbajtur më 16 janar 2014, faqe 11 (Versioni në gjuhën angleze).

<sup>9</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të Gjykatës Themelore të Prishtinës (PKR 955/13) i seancës së mbajtur më 22 janar 2014, faqe 19 (Versioni në gjuhën angleze).



*b. H.J.*

Sa i përket dëshmitares H.J., ajo personalisht nuk e ka identifikuar të pandehurin në vendin e krimit, por e kishte dëgjuar axhën (dajën) e saj duke thënë se 'I' ishte atje. Deklarata e saj lidhur me praninë e të pandehurit në vendin e krimit prandaj është provë rrethanore, por si e tillë mund të përdoret për t'i vërtetuar provat e dhëna nga dëshmitaret S.G., N.B., S.J. dhe H.B.. Kolegji e vëren se në deklaratën e saj fillestare në mars 2012 H.J. nuk e kishte përmendur se axha (daja) i saj i kishte thënë se 'I.' kishte qenë atje. Gjykata Themelore megjithatë e kishte adresuar çështjen në fjalë kur e kishte marrë në pyetje H.J. gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 28 janar 2014. Kryetari i turpit gjykues e kishte pyetur H.J. pse nuk e kishte përmendur se axha (daja) i saj i kishte treguar për këtë qysh në deklaratën fillestare të dhënë në mars 2012, kur ajo ishte pyetur nëse e njilhte ndonjërin prej kryerësve. Në përgjigjen e dhënë H.J. kishte thënë: "*Ai më ka pyetur a i njoh ata dhe unë kam thënë jo, sepse nuk i njoh, vetëm kam dëgjuar axhën (dajën) duke thënë atë që ju kam thënë se e kishte treguar.*"<sup>10</sup> Gjykata Themelore më tutje e kishte adresuar këtë çështje në aktgjykimin e kundërshtuar, në faqen 30 të aktgjykimit (sipas numrit të faqeve në versionin anglisht). Në përputhje me këtë, Gjykata Themelore në mënyrë specifike e ka adresuar këtë çështje dhe pastaj ka ardhur në përfundim se kjo nuk e zbeh kredibilitetin dhe besueshmërinë e deklaratës së dëshmitares. Kolegji nuk e sheh ndonjë arsye për të konstatuar se Gjykata Themelore ka gabuar duke vepruar kështu, prandaj kolegji pajtohet me arsyetimin e Gjykatës Themelore.

*c. N.B. dhe B.B.*

Dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët N.B. dhe B.B. nuk janë marrë për bazë gjatë vërtetimit të pranisë së të pandehurit në vendin e krimit dhe kolegji prandaj përmbahet nga shtjellimi i deklaratave të tyre dhe mjaftohet duke iu referuar të gjeturave të Gjykatës Themelore siç përcaktohet në faqet 48 dhe 49 të aktgjykimit të kundërshtuar (sipas renditjes së faqeve në versionin anglisht), të cilin kolegji e vërteton.

*d. Kontesti pronësor*

Mbrojtja pohon se motivimi i dëshmitareve për ta akuzuar të pandehurin buron nga një kontest pronësor. Ky është një pohim shumë i rëndë por jo i saktë. Kolegji, pas shqyrtimit të kujdesshëm të argumenteve të prezantuara të mbrojtjes, të arsyetimit të Gjykatës Themelore dhe të shkresave të lëndës si tërësi, nuk bindet nga i pandehuri kur ai pretendon se dëshmitaret e kanë fabrikuar njohjen dhe identifikimin e tij. Gjykata Themelore në mënyrë adekuate ka adresuar çështjen në fjalë në aktgjykimin e kundërshtuar, faqet 42 - 43 (sipas renditjes së faqeve në versionin në

---

<sup>10</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të Gjykatës Themelore të Prishtinës (PKR 955/13, GJPP 413/2012, PPS 85/2013) i seancës së mbajtur më 28 janar 2014, faqe 12 (Versioni në gjuhën angleze).

anglisht) dhe pasi që mbrojtja nuk ka sjellë asnjë argument të ri, kolegji i vërteton konkluzionet dhe arsyetimin e Gjykatës Themelore.

#### *e. Konkluzioni*

Si konkluzion, kolegji është i bindur se Gjykata Themelore në mënyrë të plotë dhe të drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe se argumentet e ngritura në ankesa nuk i zbehin të gjeturat në fjalë. Ankesa e mbrojtjes prandaj refuzohet si e pabazë.

#### D. Periudha kohore

Mbrojtja e ngre si çështje periudhën relativisht të gjatë kohore e cila ka kaluar që nga ndodhja e veprës penale në fjalë gjer te ngritja e kallëzimit penal. Megjithatë, mbrojtja nuk e përkufizon asnjë pasojë juridike apo shkelje të pretenduar lidhur me këtë çështje. Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se kemi të bëjmë me shkelje të afatit të parashkrimit; një argument i tillë është i paqartë dhe po ashtu edhe i pabazë. Në bazë të nenit 100 të KP të RSFJ-së dhe nenit 111 të KPP-së nuk ka afate parashkrimi kur kemi të bëjmë me veprë penale të krimeve të luftës. Rrjedhimisht nuk kemi as shkelje në këtë drejtim.

#### E. Konflikti i armatosur

Kolegji pajtohet me arsyetimin e Gjykatës Themelore se më datën 26 mars 1999, në kohën kur është kryer vepra penale në fjalë, në Kosovë ka ekzistuar konflikti i armatosur që ka qenë në zhvillim e sipër, duke e përfshirë këtu edhe Fushë Kosovën. Për më tepër, lidhja në mes të sjelljes së të pandehurit dhe konfliktit të armatosur në fjalë po ashtu është vërtetuar drejt edhe nga ana e Gjykatës Themelore. Duke e parë se mbrojtja nuk e ka kontestuar ekzistimin e konfliktit të armatosur, as elementet e veprës penale në fjalë, kolegji do të përmbahet nga shtjellimi i mëtejshëm lidhur me këtë çështje. Kolegji i vërteton të gjeturat e Gjykatës Themelore, ashtu siç janë cekur prej faqes 8 deri në faqen 24 të aktgjykimit të kundërshtuar (sipas renditjes së faqeve në versionin në gjuhën angleze).

#### F. Zbatimi i gabueshëm i ligjit penal

Edhe pse mbrojtja nuk e parashtron një gjë të tillë, kolegji *ex officio* konstaton se Gjykata Themelore me të drejtë është mbështetur në KP të RSFJ-së dhe në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999 / 24, ndërsa Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000 / 59 nuk është e zbatueshme në këtë procedurë penale. Gjykata e Apelit më herët e ka diskutuar këtë çështje edhe në lëndët e tjera dhe për këtë arsye kolegji i përsërit të gjeturat e veta nga lënda G.<sup>11</sup>

---

<sup>11</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit (G), PAKR 55/14, 29 tetor 2014, faqe 21 dhe në vijim.

Ligji i zbatueshëm në kohën e veprës penale të kryer ka qenë KP i RSFJ-së. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999 / 24 e ka përcaktuar që ligji i zbatueshëm të jetë ligji i cili ka qenë në fuqi në Kosovë më datën 22 mars 1999. Kjo rregullore po ashtu përcakton në nenin 3 që do të konsiderohet të ketë hyrë në fuqi nga data 10 qershor 1999. Dënimi kapital është hequr me nenin 1.5 të Rregullores nr. 1999 / 24.

Më 27 tetor 2000, Përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm (PPSP) ka shpallur Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/59, me të cilën përfshihej edhe kjo dispozitë ligjore në formë të nenit 1.6:

“Për të gjitha veprat e dënueshme me dënim me vdekje sipas ligjit në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989, dënimi do të jetë dënim me burgim në mes të minimumit të përcaktuar me ligj për atë veprë dhe maksimumit prej dyzet (40) vjetësh.”

Rregullorja e njëjtë po ashtu përmbante edhe dispozitën e qartë se ky neni i ri 1.6 do të zbatohet vetëm për krimet e kryera pas datës 27 tetor 2000.

Për shkak të parimit të përgjithshëm të jo-retroaktivitetit të ligjit penal si dhe të dispozitës së qartë të cilën e përmban vetë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000 / 59, është e qartë se kjo rregullore nuk vlen për veprën penale të kryer më 26 mars 1999.

Në bazë të nenit 3 të kodit penal të tanishëm, ndaj kryerësit zbatohet ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale në fjalë ndërsa në rast të ndryshimit të ligjit të zbatueshëm para vendimit të formës së prerë, ndaj kryerësit zbatohet ligji më i favorshëm.

Dispozitën e njëjtë e përmban edhe kodi penal i cili ka qenë në fuqi nga data 6 prill 2004 deri më datën 31 dhjetor 2012, sipas nenit 2 dhe sipas nenit 4 të KP të RSFJ-së.

Kolegji konstaton se rregulla e përgjithshme e teorisë së ligjit penal që gjykatat duhet patjetër t'i marrin parasysh të gjitha ligjet të cilat kanë mundur të zbatohen ndaj kryerësit në periudhën kohore nga kryerja e veprës penale e deri te marrja e vendimit të formës së prerë, edhe pse ato ligje mund të mos jenë më në fuqi.

Kolegji konstaton se ligji më i favorshëm për të pandehurin në fjalë është KP i RSFJ-së, i ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999 / 24, e cila e anulon dënimin me vdekje. Ligjet e mëvonshme nuk janë ligje më të favorshme pasi që përcaktojnë dënime më të gjata me burgim për veprat penale të kryera.

Në bazë të nenit 142 të KP të RSFJ-së, dënimi për veprën penale të krimeve të luftës kundër popullsisë civile është së paku pesë vjet burgim apo dënim me vdekje. Siç është cekur, dënimi me vdekje është anuluar përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999 / 24. Dënimi i përgjithshëm

maksimal me burgim i përcaktuar me KP të RSFJ-së ka qenë 15 vjet burgim, në përputhje me nenin 38 (1) të KP të RSFJ-së.

Dënimi i përcaktuar për veprën penale, në bazë të nenit 142 të KP të RSFJ-së është dënimi me burgim prej 5 deri në 15 vjet. Gjykata Themelore duke vendosur se ligji i zbatueshëm për veprën në fjalë përcakton dënimin prej 5 deri në 40 vjet burgim, ka bërë lajthitje juridike, e cila duhet patjetër të korrigjohet.

Në përjashtim të kësaj që u cek më lart, kolegji nuk gjen gabime të tjera në zbatimin e ligjit penal nga ana e Gjykatës Themelore. Gjykata Themelore në mënyrë të saktë i ka vërtetuar elementet e veprës penale dhe e ka shpallur përgjegjës të pandehurin për veprën penale të krimeve të luftës kundër popullsisë civile, në bazë të neneve 22 dhe 142 të KP të RSFJ-së.

#### G. Vendimi mbi sanksionin penal

Siç është diskutuar më lart, kolegji vëren se dënimi i përcaktuar për veprën penale sipas nenit 142 të KP të RSFJ-së, lidhur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999 / 24 është dënimi me prej 5 deri në 15 vjet burgim.

Për më tepër, kolegji i ka shqyrtuar me kujdes rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese të vërtetuara nga ana e Gjykatës Themelore.

Duke i pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të vërtetuara drejt nga Gjykata Themelore dhe duke e pasur parasysh dënimin maksimal të përcaktuar për veprën penale në fjalë prej 15 vjetësh (dhe jo 40 vjetësh) burgim, kolegji vendos që dënimi prej 6 (gjashtë) vjetësh burgim është një dënim i drejtë për të pandehurin që ka kryer veprën penale të vërtetuar. Kolegji i apelit, në pajtim me nenin 41 të KP të RSFJ-së, e cakton dënimin në fjalë brenda kufijve të përcaktuar me ligj dhe duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat relevante si dhe qëllimin e dënimin të përcaktuar me nenin 33 të KP të RSFJ-së. Koha e kaluar në paraburgim nga data 26 korrik 2013, të pandehurit do t'i llogaritet në vuajtje të dënimin.

#### H. Vërejtjet përfundimtare

Gjykata e Apelit – për arsyet e shtjelluara tashmë më lart – e refuzon ankesën e mbrojtjes dhe e ndryshon *ex officio* aktgjykimin e kundërshtuar lidhur me zbatimin e ligjit penal sa i përket sanksionit penal të shqiptuar si dhe kohëzgjatjes së dënimin të shqiptuar. Kolegji e ndryshon aktgjykimin e kundërshtuar duke ia shqiptuar të pandehurit dënimin prej 6 (gjashtë) vjetësh burgim për veprën penale të kryer, në përputhje me nenet 22 dhe 142 të KP të RSFJ-së. Në pjesën tjetër aktgjykimi i kundërshtuar vërtetohet.

---

*Aktgjykimi i arsyetuar është përfunduar më 7 prill 2015*

Kryetarja e kolegjit

---

Hajnalka Veronika Karpati  
Gjyqtare e EULEX-it

Anëtarja e kolegjit

Anëtari i kolegjit

---

Elka Filcheva-Ermenkova  
Gjyqtare e EULEX-it

---

Fillim Skoro  
Gjyqtar i Kosovës

Procesmbajtësi

---

Alan Vasak  
Zyrtar ligjor i EULEX-it

---

**Gjykata e Apelit**  
Prishtinë

**PAKR 397 / 14**

**24 mars 2015**

faqe 13 nga 13